



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

**Kuvendi i Komunës**

**Nr. 002/ 05**

**Datë: 04.03. 2022**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 3 paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 28.02.2022 nxjerrë:

**V E N D I M**

**për formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022**

- I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022/në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.
  - II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022 në përputhje me nenin 3 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.
  - III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, , një përfaqësues nga ekzekutivi.
  - IV. Grupi punues përbëhet nga:
    1. Shpejtim Gacaferi -Kryetar (LDK), Kryesues i Kuvendit,
    2. Albertina Gacaferi -anëtare (LDK), Kuvendi Komunal
    3. Erleta Qestaj - anëtare (AAK), Kuvendi Komunal
    4. Eliza Pepshi -anëtare (LVV), Kuvendi Komunal dhe
    5. Leonora Shehu -anëtare nga ekzekutivi
  - IV. Afati i hartimit të (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut është më së largu deri në fund të muajit mars të këtij viti.
  - V. Pas hartimit të (projekt) Planit të punës nga ana e Grupit të punës, (projekt) Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.
  - VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
  - VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- Me këtë vendim njoftohen:
1. MAPL;
  2. Kryetari i Komunës së Junikut;
  3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
  4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit  
z. Shpejtim Gacaferi